REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 333/19
Datë/Datum. 21.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: ***KOMUNA E MITROVICËS***

Për Aktivitetin e Prokurimit: 642-19-3831-5-1-1

Sa i përket tenderit për: **Rregullimi i shtratit të Lumit IBËR në Mitrovicë-bashkëfinancim me MMPH.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"BAJRAKTARI"SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Maxhunaj Vushtrri
(Adresa)

Vushtrri
(Vendi)

42 000
(Kodi postar)

049-176495
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Mustaf Bajaraktari
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
bajraktarishpk@yahoo.com
(Adresa elektronike)

18.06.2019
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:
Zeqir Fetoshi
(Emri i avokatit)

Ndue Përlleshi hyr.B-kat.I/15-1 Prishtinë
(Adresa e plotë)

044- 238 978
049-939 555
(Numri i Telefonit)
fetoshilaw@hotmail.com
(Adresa elektronike)

(Numri i faks-it)

18.06.2019
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR FETOSHI LAW Sh.p.k. PRISHTINË

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë dt:04.06.2019
Data e fundit e dorëzimit të tenderëve:21.06.2019
Data e planifikuar e hapjes së ofertave:21.06.2019
Kërkesa për rishqyrtim dt:07.06.2019
Vendimi i AK-së për refuzim të kërkesës per rishqyrtim dt:12.06.2019

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 27 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 18.9 i RRUOPP
Neni 26.4 i RRUOPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar filimisht po ju rikujtojmë se ky aktivitet i prokurimit është Ritenderim, ndërsa ne kemi qenë ofertues edhe në herën e kaluar dhe kemi kaluar në procese të ankesave tri herë ku neve na janë aprovuar ankesat, mirëpo autoriteti kontraktues ka ndërmarr secilen herë veprime kundër neve si operator ekonomik, duke mos na shpallur asnjëherë fitues të këtij tenderi edhe pse i kemi

plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Ju rikujtojmë se herën e tretë autoriteti kontraktues e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin se asnjë ofertues nuk i plotëson kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Poashtu ju si OSHP me vendimin tuaj final e keni vërtetuar vendimin e AK-së për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit.
Pas këtij vendimi të OSHP-së, autoriteti kontraktues e ka ritenderuar këtë aktivitet të prokurimit duke i ashpërsuar dhe duke i rritur edhe më tepër kërkesat e gjendjes ekonomike financiare dhe të aftësive teknike/ose profesionale.

Tek Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale tek neni 7.1&7.2 i FDT-së pika 4) është kërkuar Vertetimi i leshuar nga Policia e Kosovës për pronarin e kompanise, jo më i vjeter se 3 muaj nga data e publikimit te njoftimit per kontrate.

Kjo kërkesë për mendimin tonë është e panevojshme dhe shkakton vetëm ngarkesë për përgatitje të tenderit dhe këtë kërkesë e mbulon çdo herë deklarata nën betim e operatorëve ekonomik që e plotësojnë dhe që gjendet në dosje të tenderit tek aneksi 2, e ku operatorët ekonomik konfirmojnë se i përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje ne këtë procedure te prokurimit. Prandaj kjo kërkesë vetëm se e dyfishon dhe i duplifikon dokumentet dhe dëshmitë e kërkuara.

Gjithashtu me këtë kërkesë cenohet edhe prezumimi i pafajësisë sepse nëse dikush mund të jetë nën hetime nuk nënkupton që është edhe fajtor.

Sa i përket kërkesave në lidhje me Kapacitetin teknik dhe profesional:në nenin 9.1 & 9.2 të FDT-së, në lidhje me menaxherin e projektit dhe udhëheqësin e punishtes autoriteti kontraktues ka kërkuar që ti kenë nga 10 vite përvojë pune pas diplomimit dhe që të jenë kontratat primare dhe të jenë në listën e pagave të liderit në 6 muajt e fundit të vitit. Këto kërkesa janë jashtë maksimumit të lejuar dhe parashikuar, ndërsa kërkesa që këta inxhinierë të jenë të lideri në listë të pagave së paku në gjashtëmujorin e fundit nga njoftimi për kontratë është kërkesë favorizues/diskriminuese dhe bie në kundërshtim edhe me nenin 71 të LPP-së sepse në paragrafin 4 të këtij neni ceket qartë "*Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.*Autoriteti kontraktues në këtë rast me këto kërkesa, nuk e ka pasur parasysh nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik, sepse aty shkruan qartë se "*Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike*".

Autoritet kontraktues me këto kërkesa ia ka humbur rëndësinë anëtarëve të konsorciumit, gjithashtu nuk e ka parashikuar fare që udhëheqësi i punishtes dhe projekt menaxheri mund të ketë parakontratë me kompaninë eventuale fituese. Gjithashtu ky fakt bie në kundërshtim me nenin 69 paragrafi 8 të LPP-së ku shkruan se "*Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta*".

Njëkohësisht edhe kërkesa e autoritetit kontraktues që të gjitha diplomat dhe kualifikimet e arritura në vendet jashtë Republikës së Kosovës të jenë të nostrifikuar janë kërkesa të panevojshme, sepse këtë inxhinierë nuk po aplikojnë për studime të doktoratës apo për ndonjë vend pune në institucione publike, prandaj edhe kjo kërkesë duhet të largohet sepse për çdo veprim apo mosverpim në punë dhë gjatë punës e mban përgjegjësinë pala nënshkruese e kontratës pra operatori ekonomik.Në të gjitha vendet evropiane është praktikë e mirë që të minimizohen dhe

zvogëlohen kërkesat e jo të ngarkohen operatorët ekonomik me formalizma dhe procedura të panevojshme, sepse në raste të caktuara janë të mjaftueshme edhe vetëm deklarat nën betim.

Edhe kërkesa e autoritetit kontraktues se OE (lideri) duhet te ofroje listen e punetorve nga ATK minimum 50 punëtorë në 6 muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontratë, është kërkesë favorizuese/diskriminuese dhe bie në kundërshtim edhe me nenin 71 të LPP-së sepse në paragrafin 4 të këtij neni ceket qartë "*Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit, prandaj duhet të largohet kjo kërkesë dhe të ndryshohet.* Sepse është e rëndësishme që operatorët ekonomik apo konsorciumet ti kenë kapacitetet teknike dhe profesionale për të realizuar projektet, pavarësisht a i ka lideri apo anëtari i konsorciumit.

I njëjti pretendim i joni dhe konstatim qëndron edhe për kërkesën e autoritetit kontraktues ku është kërkuar "Lista e pajisjeve dhe dokumentet qe ofrohen per makineri të obliguara sipas ANEXIT 1 të FDT-së, duhet te jene te noterizuara dhe me regjistrim valid dhe ne rast konsorciumi lideri duhet ti kete ne pronesi 60% te paisjeve. Për këto kërkesa shtrohet një pyetje, përse me LPP janë paraparë mundësitë e formimit dhe themelimit të konsorciumeve? dhe si do të bëhen lider (në të ardhmen) kompanitë tjera të vogla me këto kërkesa. E rëndësishme është që operatorët ekonomik apo antërat e konsorciumit ti kenë këto makineri apo pajisje me qëllimit të kryerjes së punëve me sukses. Prandaj kjo kërkesë duhet ndryshuar dhe larguar sepse është favorizuese/diskriminuese.

Autoriteti kontraktues në pikën 5 të nenit 9.1&9.2 të FDT-së ka parashikuar që O.E duhet te kete minimum katër(4) punonjes te certifikuar si manipulues te eskavatorëve nga nje institucion i Republikes se Kosoves që posedon qendren e trajnimit për këtë lëmi. Kjo kërkesë është hapur diskriminuese sepse me këtë kërkesë një punonjës i cili mund të jetë i certifikuar jashtë shtetit të Kosovës nuk mund të jetë i prezantuar nga kompania e caktuar në këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa në tenderë tjerë edhe nëse kërkohet që është i certifikuar vetëm në shtetet e bashkimit evropian konsiderohet diskriminim, kurse autoriteti kontraktues e ka kufizuar që të jetë i certifikuar vetëm në Republikën e Kosovës.Ky kundërshtim i joni vlen edhe për pikat 6, 7, 8, 9 nenit 9.1&9.2 të FDT. Gjithashtu për pikat 5, 6, 7, 8, 9 autoriteti kontraktues ka kërkuar që të jenë në listën e pagave të liderit minimum 6 muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Fakti se punëtorët janë tek lideri apo te anëtari i konsorciumit nuk luan asnjë rol, por me rëndësi është që të mbulohet kërkesa me numër të punëtorëve dhe pak ka rëndësi se nga cili anëtarë i konsorciumit mbulohet.

Sa i përket kërkesës me nr.10 të nenit nenit 9.1&9.2 të FDT ku autoriteti kontraktues ka kërkuar që O.E. duhet te kete minimum një(1) punonjes si manipulues per cisternat e karburanteve me ADR, ndërsa dëshmi e kërkuar dokumentare që "*O.E si deshmi duhet të ofrojë Kontraten e punes, e noterizuar Te jete ne listen e pagave minimum 6 muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate. Certifkaten ADR, kopje e noterizuar*, kërkojmë nga autoriteti kontraktues që të largohet kërkesa për certifikatën ADR dhe të largohet kërkesa-dëshmia që punonjësi-manipuluesi i cisternës te jetë në listen e pagave minimum 6 muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontrate dhe të krijohet mundësia që OE të dëshmojnë edhe me parakontrata se i kanë në dispozicion stafin në përgjithësi.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizues dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*
Pra me këto kërkesa dhe dëshmi të kërkuara, mundësia është shumë e madhe dhe pothuajse e

pashmangshme e dëmtimit të buxhetit, sepse kompanitë e caktuara (favorizuese) mund të ofertojnë me çmime shumë më të larta dhe eventualisht të nënshkruajnë kontratë, pasi që në Kosovë dihet se kush mund ti plotësojë këto kërkesa dhe dëshmi dokumentare, prandaj mundësia e manipulimit me çmime kur përshtaten kërkesat është shumë e madhe.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton se autoriteti kontraktues nuk e ka përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e kanë pasur parsysh as nenin 18.9 të RRUOPP ku shkruan qartë që "*Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:* ***Kufizon konkurrencën në mesin e OE****, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë EO-ve.*

Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj të gjitha kërkesat të cilat i kontestuam më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit pothuajse mbi 95 % të kompanive vendore dhe këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik, sepse aty shkruan qartë se "*Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj* ***kërkesat minimale*** *të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike*".

Pra autoriteti kontraktues në vend se të ketë parasysh edhe zhvillimin e operatorëve ekonomik të rinjë, përveç se nuk e kanë marr parasyh këtë dispozitë, autoriteti kontraktues i ka diskriminuar hapur edhe operatorët ekonomik tjerë më shumë përvojë në fushën e ndërtimit.

Autoriteti kontraktues pas dështimit të këtij aktiviteti të prokurimit dhe anulimit në herën e kaluar, me rastin e ritenderimit është dashur ta ketë parasysh arsyen e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit dhe është dashur ta zvogëlojë dhe ti zbut kriteret, kërkesat dhe dëshmitë e kërkuara dokumentare me qëllim që të kemi një procedurë të rregullt të këtij aktiviteti të prokurimit dhe për të finalizuar këtë projekt, e jo të bëhen ndryshime drastike të kërkesave duke e bërë edhe më të ashpër dhe më kufizuese konkurencën.

Në vendimin e AK-së per refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt:12.06.2019, autoriteti kontraktues në asnjë aspekt nuk ka mundur të argumentojë kërkesat e vendosura në FDT dhe tek njoftimi për kontratë, mirëpo vetëm ka qëndruar pranë kërkesave të tyre.

Ne si operatorë ekonomik kërkojmë që të ndryshohen të gjitha ato kërkesa që i kontestuam më lartë, dhe kërkojmë që këto kërkesa të përpilohen dhe hartohen konform dispozitave të LPP-së, praktikave më të mira evropiane, gjithnjë duke pasur parasysh që konkurenca të mos jetë e kufizuar, të merren parasysh ofertuesit e rinjë të mundshëm, dhe të merren parasysh dispozitat e nenit 1, 6, 7, 27, 68, 69, 72 të LPP-së.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja, që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE "Bajraktari Shpk"
OBLIGOHET, autoriteti kontraktues, ti bëjë ndryshimet e dosjes së tenderit të cekura më lartë dhe

pastaj të veprohet konform nenit 53 të LPP-së, ose të anulohet në tërësi ky njoftim për kontratë dhe të hartohet rishtazi dosja e tenderit me kërkesa dhe specifika tjera.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitnikërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*